**LIGJ**
**PER REGJISTRIN QENDROR TE POPULLSISE**

## I. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

### 1. LENDA E LIGJIT

**Neni 1**

Me kete ligj rregullohen te drejtat, obligimet dhe pergjegjesite e organeve te administrates shteterore, njesive te veteqeverisjes lokale dhe organeve tjera shteterore te themeluara ne pajtim me Kushtetuten dhe me ligjin, gjykatave, prokurorive publike, avokatise shteterore, personave juridike dhe personave tjere te cileve me ligj u eshte besuar te kryejne autorizime publike, personave juridike qe japin dhe sigurojne sherbime me interes publik, perkatesisht subjekteve nga sfera e arsimit, shendetesise, mbrojtjes sociale dhe te femijeve, financave, bankarise, sigurimit, energjetikes, furnizimit me uje, komunikimeve elektronike, sherbimeve postare dhe sherbimeve komunale, qe kane te bejne me Regjistrin Qendror te Popullsise, strukturen dhe permbajtjen e Regjistrit Qendror te Popullsise, kushtet per shfrytezimin e tij, shkembimin e te dhenave ndermjet organeve kompetente dhe subjekteve tjera, si dhe te drejtat dhe obligimet e popullsise ne Republiken e Maqedonise se Veriut.

### 2. QELLIMI I LIGJIT

**Neni 2**

(1) Qellimi i ketij ligji eshte sigurimi i qasjes ne te dhenat per popullsine ne Republiken e Maqedonise se Veriut per realizimin e te drejtave dhe obligimeve ose shfrytezimin e sherbimeve te siguruara nga organet kompetente ose personat tjere, ne pajtim me ligjin.

(2) Me vendosjen e Regjistrit Qendror te Popullsise (ne tekstin e metejme: Regjistri), i cili mbahet ne Ministrine e Shoqerise Informatike dhe Administrates ne forme elektronike, sigurohet menyra e unifikuar dhe e vetme e mbajtjes se bazave te vecanta te te dhenave per popullsine, ne baze te standardeve dhe procedurave te percaktuara, ne pajtim me dispozitat e ketij ligji.

### 3. ZBATIMI I LIGJIT

**Neni 3**

(1) Me dispozitat e ketij ligji rregullohet realizimi i kompetencave te percaktuara me ligjin per organet e administrates shteterore, njesite e veteqeverisjes lokale dhe organet tjera shteterore te themeluara ne pajtim me Kushtetuten dhe me ligjin, gjykatat, prokurorite publike, avokatine shteterore, personat juridike dhe fizike te cileve me ligj u eshte besuar te kryejne autorizimeve publike, personat juridike te cilet japin dhe sigurojne sherbime me interes publik,

perkatesisht subjektet nga sfera e arsimit, shendetesise, mbrojtjes sociale dhe te femijeve, financave, bankarise, sigurimit, energjetikes, furnizimit me uje, komunikimeve elektronike, sherbimeve postare dhe sherbimeve komunale, gjate sigurimit te sherbimeve per realizimin e te drejtave dhe obligimeve me interes dhe per nevojat e popullsise ne Republiken e Maqedonise se Veriut, lidhur me te dhenat e permbajtura ne Regjister.

(2) Me dispozitat e ketij ligji rregullohet mbajtja e bazave te vecanta te te dhenave nga organet kompetente, ne pajtim me dispozitat e ketij ligji.

(3) Me dispozitat e ketij ligji rregullohet edhe qasja dhe perpunimi i te dhenave te permbajtura ne Regjister nga subjekte tjera, ne pajtim me dispozitat e ketij ligji.

(4) Dispozitat e ketij ligji kane te bejne me te dhenat personale te qytetareve te Republikes se Maqedonise se Veriut, qe jetojne ne shtet ose jashte vendit, si dhe te dhenat per shtetasit e hua j me qendrim te rregulluar ne Republiken e Maqedonise se Veriut me gjate se nje vjet.

(5) Dispozitat e ketij ligji zbatohen per realizimin e kompetencave te percaktuara me ligj per organet e administrates shteterore qe kane per qellim mbrojtjen e rendit juridik, parandalimin dhe zbulimin e veprave ndeshkuese si dhe ndermarrjen e masave per ndjekjen e kryeresve te ketyre veprave te percaktuara me ligj.

(6) Dispozitat e ketij ligji nuk kane te bejne me te dhenat personale te personave fizike te cilet jane derguar per qendrim te perkohshem ne Republiken e Maqedonise se Veriut per shkak te kryerjes se detyrave te punes per qellimet e perfaqesive te huaja diplomatike, misioneve ose perfaqesive konsullore, anetareve te familjeve te tyre qe qendrojne ne Republiken e Maqedonise se Veriut, personave fizike qe jane perjashtuar nga zbatimi i se drejtes vendore ne baze te konventave nderkombetare, personave me qendrim te rregulluar afatshkurter ne Republiken e Maqedonise se Veriut, si dhe te gjithe personave tjere te perfshire me Konventen e Vjenes per marredheniet diplomatike nga viti 1961, Konventen e Vjenes per marredheniet konsullore nga viti 1963 ose Konventen e Vjenes per perfaqesimin e shteteve ne marredheniet e tyre me organizatat nderkombetare me karakter universal nga viti 1975.

## 4. PERKUFIZIME

**Neni 4**

(1) Shprehje te vecanta te perdora ne kete ligj e kane kuptimin si vijojne:

1. Regjisetr Qendror i Popullsise eshte baza e integruar e te dhenave personale te popullsise ne Republiken e Maqedonise se Veriut, e krijuar ne baze te integrimit automatik te te dhenave te permbajtura ne bazat e vecanta te te dhenave qe i mbajne organet kompetente, ne pajtim m e kompetencat e tyre te percaktuara ligjore, nepermjet perdorimit te algoritmeve dhe proceseve te lidhura ne menyre logjike qe i pastrojne te dhenat personale te popullsise, e cila baze e te dhenave e permban regjistrimin e fundit ose regjistrimin e ndryshimit te se dhenes personale, te evidentuar ne bazen e vecante te te dhenave ne kompetence te organit shteteror konkret – burim i te dhenave;
2. Kontrollues dhe perpunues i te dhenave nga Regjistri eshte Ministria e Shoqerise Informatike dhe Administrates (ne tekstin e metejme: Ministria);
3. Shfrytezues i te dhenave nga Regjistri jane organet kompetente dhe subjektet tjera qe kane nivel perkates te qasjes ne te dhenat personale, ne varesi nga kompetenca e vet, per realizimin e kompetencave te veta te percaktuara ligjore;

4. Perpunues i dhe shfrytezues unik i te dhenave nga Regjistri eshte organi i administrates shteterore kompetent per kryerjen e puneve nga sfera e statistikes shteterore, ne pajtim me Ligjin per statistike shteterore;

5. Popullsia jane qytetaret e Republikes se Maqedonise se Veriut, qe jetojne ne shtet ose jashte vendit, si dhe shtetasit e huaj me qendrimin e rregulluar ne Republiken e Maqedonise se Veriut me gjate se nje vjet.

6. Organ kompetent jane organet e administrates shteterore, njesite e veteqeverisjes lokale dh e organet tjera shteterore te themeluara ne pajtim me Kushtetuten dhe me ligjin, qe sigurojne sherbime per realizimin e te drejtave dhe obligimeve me interes dhe per nevojat e popullsise ne Republiken e Maqedonise se Veriut;

7. Subjekte tjera ne kuptim te ketij ligji jane:

- gjykatat, prokurorite publike, avokatia shteterore,
- personat juridike dhe te tjere te cileve me ligj u eshte besuar te kryejne autorizime publike,
- personat juridike qe japin dhe sigurojne sherbime me interes publik, perkatesisht subjektet nga sfera e arsimit, shendetesise, mbrojtjes sociale dhe te femijeve, financave, bankarise, sigurimit, energjetikes, furnizimit me uje, komunikimeve elektronike, sherbimeve postare dhe sherbimeve komunale;

8. Kripcion i te dhenave eshte proces i lidhur logjik i realizuar me shfrytezimin e alogoritmeve nepermjet te cilit sigurohet sekreti dhe fshehtesia e te dhenave ne komunikim ndermjet organeve dhe subjekteve kompetente dhe paraqet mase per parandalimin e qasjes s e paautorizuar te Regjistri dhe njekohesisht e verteton integritetin dhe burimin e te dhenave;

9. Burim i te dhenave eshte organi kompetent i cili per here te pare kryen regjistrimin, ndryshimin ose shlyerjen e se dhenes personale dhe siguron ruajtjen e te dhenave personale ne baze te ligjit dhe ky e ka cilesine e kontrolluesit dhe perpunuesit te te dhenave nga bazat e vecanta te te dhenave;

10. Person i autorizuar eshte:

- personi i punesuar ne organin kompetent i cili ne pajtim me pershkrimin dhe llojin e detyrave te punes eshte i autorizuar ta beje pranimin e kerkesave per regjistrimet ose ndryshimet e te dhenave personave te parashtruara nga personat fizike gjate shfrytezimit te sherbimeve te ketij organi,
- personi udheheqes i organit kompetent, personi udheheqes i subjektit tjeter ose personi i punesuar ne organin kompetent ose subjekti tjeter, i cili ne pajtim me pershkrimin dhe llojin e detyrave te punes eshte i autorizuar te leshoje akte konkrete ne emer te organit kompetent ose subjektit tjeter, pas autorizimit paraprak te personit udheheqes i cili udheheq me organin kompetent ose subjektin tjeter,
- personi i punesuar ne subjektin tjeter i cili ne pajtim me pershkrimin dhe llojin e detyrave te punes eshte i autorizuar ta beje pranimin e kerkesave per regjistrimet ose ndryshimet e te dhenave personale te parashtruara nga personat fizike ose te leshoje dokumentacion ne emer te personit juridik – subjektit tjeter;

11. Status i setit te te dhenave eshte statusi i setit konkret te te dhenave personale qe kane te bejne me personin fizik konkret te evidentuar ne bazat e vecanta te te dhenave dhe mund te jete e dhene aktive ose pasive, varesisht nese subjekti i te dhenave personale eshte i gjalle ose i vdekur;

12. Eksportimi i te dhenave eshte proces i lidhur logjik nepermjet shfrytezimit te algoritmeve per nxjerrjen e sigurte te te dhenave nga Regjistri;

13. Set i te dhenave eshte kombinimi i me teper te dhenave te vecanta personale qe kane te bejne me personin fizik konkret nga te cilat mund te percaktohet per cilin person fizik kane te bejne edhe keto e paraqesin permbajtjen e cdo baze te vecante te te dhenave qe e mban organi kompetent, ne pajtim me ligjin;

14. Koha reale e shenon kohen ne te cilen behet regjistrimi, ndryshimi ose shlyerja ne momentin e ndermarrjes se aktivitetit konkret, me shmangie prej 5 minutash nga koha e regjistrimit, ndryshimit ose shlyerjes te kryer ne menyre te rregullt.

15. Gjenerim ne kuptim te ketij ligji eshte procesi i lidhur logjik qellimi i te cilit eshte krijimi i kerkesave ose veprimeve tjera ne qarkullimin juridik, me zbatimin e teknologjive informatike te komunikimit.

(2) Shprehjet tjera te perdora ne kete ligj kane kuptim te caktuar me ligj.

## 5. PARIMI PER MBAJTJEN E REGJISTRIT

### Sekreti

### Neni 5

Te dhenat e permbajtura ne Regjister jane te dhenat personale dhe perpunohen ne pajtim me ligjin.

### Integriteti i te dhenave

### Neni 6

Burimet e te dhenave kane per detyre te sigurojne kripcion te te dhenave gjate komunikimit ndermjet organeve kompetente dhe subjekteve me qellim qe te sigurohet integriteti i tyre.

### Unifikimi

### Neni 7

Te dhenat e permbajtura ne Regjister evidentohen ne menyren unike edhe ne bazat e vecanta te te dhenave permes shfrytezimit te proceseve te lidhura logjike dhe algoritmeve ne funksion te pastrimit te te dhenave, ne pajtim me standardet per cilesine e te dhenave.

### Arritshmeria

### Neni 8

Te dhenat nga Regjistri u jane te arritshme organeve kompetente dhe subjekteve tjera te percaktuara me kete ligj dhe keto shfrytezohen ne pajtim me kushtet e percaktuara me kete ligj dhe rregullat nga sfera e mbrojtjes se te dhenave personale.

**Shkembimi i unifiku ar**

**Neni 9**

(1) Me qellim qe te vendoset menyra e unifikuar e shkembimit te te dhenave nga bazat e vecanta, percaktohen standardet per cilesine e te dhenave ne bazat e vecanta te te dhena ve te organeve kompetente.

(2) Standardet per cilesine e te dhenave ne bazat e vecanta te te dhenave te organe ve kompetente i percakton ministri i Shoqerise Informatike dhe Administrates.

## II. KONTROLLUESI, PERPUNUESI, STRUKTURA DHE PERMBAJTJA E REGJISTRIT

### 1. KONTROLLUESI DHE PERPUNUESI I REGJISTRIT

**Neni 10**

(1) Kontrollues dhe perpunues i Regjistrit eshte Ministria e Shoqerise Informatike dhe Administrates, e cila siguron mjedis unik per qasjen e organeve kompetente dhe subjekteve tjera, nepermjet te cilit mundesohet procesi i integrimit te bazave te vecanta t e te dhenave qe e paraqesin permbajtjen e Regjistrit.

(2) Ministria e Shoqerise Informatike dhe Administrates, ne cilesine e kontrolluesit dh e perpunuesit te Regjistrit, kryen integrimin unik automatik pa te drejten e futjes ose ndryshimit te te dhenave nga Regjistri, ne pajtim me rregullat nga sfera e mbrojtjes se te dhenave personale.

### 2. KONTROLLUESIT DHE PERPUNUESIT E PERMBAJTJES SE TE DHENAVE NGA REGJISTRI

**Neni 11**

(1) Kontrollues dhe perpunues e permbajtjes se te dhenave nga Regjistri jane: Ministria e Puneve te Brendshme, Ministria e Drejtesise – Drejtoria per Mbajtjen e Librave te Amzes dhe organi kompetent per mbajtjen e regjistrit te adreses se Republikes se Maqedonise se Veriut.

(2) Organet nga paragrafi (1) i ketij neni jane burimet e te dhenave te permbajtura n e Regjister.

### 3. INTEGRIMI I TE DHENAVE TE PERMBAJTURA NE BAZAT E VECANTA TE TE DHENAVE

**Neni 12**

(1) Integrimi i te dhenave te permbajtura ne bazat e vecanta te te dhenave, qe e paraqesi n permbajtjen e Regjistrit, behet me perdorimin e proceseve te lidhura logjike dhe algoritmeve qe

sigurojne krahasimin e gjeneruar automatik te te dhenave nga bazat e vecanta te te dhenave te burimeve te te dhenave.

(2) Integrimi i te dhenave behet nepermjet mjedisit unik, ne kohe reale.

## 4. PERMBAJTJA E TE DHENAVE NE REGJISTER

### Neni 13

(1) Regjistri i permban te dhenat personale si vijon:

1) Emrin
2) Mbiemrin
3) NUAQ
4) Gjinine
5) Datelindjen
6) Vendlindjen
- Shtetin
- Komunen
- Vendbanimin
7) Dokumentet personale
- Dokumentin
- Numrin e dokumentit
- Llojin e dokumentit
- Daten e leshimit te dokumentit
- Daten e vlefshmerise se dokumentit
- Statusin e dokumentit
- Vendin e leshimit te dokumentit
8) (NUAQ) te nenes
9) (NUAQ) te babait
10) Adresen e vendbanimit
-Komunen
- Vendbanimin
- Rrugen
- Numrin (numrin, hyrjen, banesen)
- Shtesen e numrit
11) Adresen e qendrimit te perkohshem
- Komunen
- Vendbanimin
- Rrugen
- Numrin (numrin, hyrjen, banesen)
- Shtesen e numrit
12) Shtetesine
- Shtetin
- Statusin
- Daten e fillimit
- Daten e nderprerjes
13) Statusin martesor
- Daten e statusit martesor
- Bashkeshort / -e (NUAQ)
14) Vdekjen
- Daten e vdekjes
- Vendin e vdekjes

- Shtetin
- Komunen
- Vendbanimin

(2) Te dhenat nga paragrafi (1) i ketij neni organet kompetente dhe subjektet tjera mund t'i perdorin vetem per sigurim te sherbimeve te personave fizike, ne pajtim me ligjin.

(3) Me perjashtim nga paragrafi (2) i ketij neni, te dhenat nga paragrafi (1) i ketij neni i perdorin organet kompetente te administrates shteterore gjate kryerjes se kompetencave te tyre t e percaktuara ligjore qe kane per qellim mbrojtjen e rendit juridik, parandalimin dhe zbulimin e veprave ndeshkuese, si dhe ndermarrjen e masave per ndjekjen e kryeresve te ketyre veprave te percaktuara me ligj.

## 5. NOTIFIKIMI PER MOSPERPUTHJEN E TE DHENAVE

**Ne**
**ni**
**14**

(1) Ne rast kur ekziston mosperputhja e te dhenave personale te permbajtura ne bazat e vecanta te te dhenave, Regjistri dergon notifikim per mosperputhjen e te dhenave te burimi i te dhenave i cili shmanget ne bazen e te dhenave te te cilit eshte evidentuar shmangia.

(2) Ne rastet nga paragrafi (1) i ketij neni, e sakte konsiderohet e dhena qe eshte evidentuar e fundit per regjistrim ose ndryshim te se dhenes personale ne bazen perkatese te te dhenave t e burimit te se dhenes, ne pajtim me ligjin.

## 6. SHFRYTEZIMI I TE DHENAVE NGA REGJISTRI

**Ne**
**ni**
**15**

(1) Organet kompetente dhe subjektet tjera kane per detyre t'i shfrytezojne te dhenat nga Regjistri vetem per realizim te kompetencave te veta te percaktuara ligjore ose per shkak te ushtrimit te veprimtarise per te cilen jane regjistruar, ne menyre perkatese per realizimin e qellimit per te cilin i sigurojne sherbimet e personave fizike, ne pajtim me ligjin.

(2) Personat e autorizuar te organeve kompetente dhe subjekteve tjera e kane te drejten e
qasjes ne te dhenat e permbajtura ne Regjister, me kushtet dhe ne proceduren e percaktuar m e ligj, gjate sigurimit te sherbimeve per realizimin e te drejtave dhe obligimeve me interes dhe per nevojat e personave fizike.

(3) Personat fizike, te dhenat e te cileve jane te permbajtura ne Regjister kane te drejten e qasjes vetem ne te dhenat e veta personale, per realizim te se drejtes ose permbushjes s e obligimit para organit kompetent ose subjektit tjeter, ne pajtim me kete ligj.

(4) Me perjashtim nga paragrafet (1) dhe (2) te ketij neni, organet e administrates shteterore qe kane per qellim mbrojtjen e rendit juridik, parandalimin dhe zbulimin e veprave ndeshkuese, si dhe ndermarrjen e masave per ndjekjen e kryeresve te ketyre veprave te percaktuara me ligj, kane te drejte t'i shfrytezojne te dhenat nga Regjistri vetem per realizim te kompetencave te veta te percaktuara ligjore.

# III. TE DREJTAT DHE OBLIGIMET E PERGJITHSHME DHE TE VECANTA

## 1. TE DREJTAT DHE OBLIGIMET E ORGANEVE KOMPETENTE DHE SUBJETEVE TJERA

### Obligimet e pergjithshme te organeve kompetente dhe subjekteve tjera

**Ne ni 16**

Organet kompetente dhe subjektet tjera jane te detyruara qe gjate sigurimit te sherbimeve ne forme elektronike permes Portalit nacional per sherbime elektronike t'i zbatojne ligjet me te cilat eshte percaktuar procedura per sigurim te sherbimeve, e vecanerisht rregullat nga sfera e mbrojtjes se te dhenave personale.

**Obligimet e vecanta te burimeve te te dhenav e**

**Ne ni 17**

(1) Burimet e te dhenave te perfshira ne Regjister, te percaktuara ne nenin 11 te ketij ligji, jane te detyruar qe t'i integrojne te dhenat vijuese:

1. Ministria e Drejtesise - Drejtoria per mbajtje te librave te amzes: A. Nga libri i amzes i te lindurve:

- NUAQ
- Emrin
- Mbiemri
- Gjinia
- Datelindja
- Vendlindja
-Shteti
-Komuna
-Vendbanimi
- Nena (NUAQ)
- Babai (NUAQ)

B. Nga libri i amzes i te kurorezuarve:

- Statusi martesor
-Data e statusit martesor
-Bashkeshorti/ja (NUAQ)

C. Nga libri i amzes i te vdekurve:

- Vdekja
-Data e vdekjes
-Vendi i vdekjes
-Shteti
-Komuna
-Vendbanimi

2. Ministria e Puneve te Brendshme, per te dhenat administrative si vijon:

A. Dokumentet personale

-Dokumenti
-Numri i dokumentit
-Lloji i dokumentit
-Data e leshimit te dokumentit
-Data e vlefshmerise se dokumentit
-Statusi i dokumentit
-Data e leshimit te dokumentit

B. Adresa e vendbanimit

-Komuna
-Vendbanimi
-Rruga
-Numri (Numri, Hyrja, Banesa)
- Shtesa e numrit
C. Adresa e qendrimit te perkohshem
-Komuna
-Vendbanimi
-Rruga
-Numri (Numri, Hyrja, Banesa)
- Shtesa e numrit
C. Shtetesia
-Shteti
-Statusi
-Data e fillimit
-Data e nderprerjes

(2) Per menyren e eksportimit te te dhenave nga paragrafi (1) i ketij neni qe i formojne permbajtjet e seteve te te dhenave, burimet e Ministrise se Shoqerise Informatike dhe Administrates lidhin marreveshje te vecante per harmonizim teknik per marrjen e te dhenave.

**Obligimi i te dhenave burimo re**

**Ne ni 18**

(1) Burimet e te dhenave jane te detyruara qe te kryejne regjistrim, regjistrim te ndryshimeve, te sigurojne ruajtje dhe fshirje te te dhenave burimore, ne kushte dhe ne procedure te percaktuar me ligj.

(2) Burimet e te dhenave jane te detyruar qe te sigurojne integrim te sigurt te bazave te vecanta te te dhenave ne Regjister permes mjedisit unik.

(3) Menyra dhe procedurat teknike te kryerjes se regjistrimit, ruajtjes dhe fshirjes se te dhenave burimore ne regjister i percakton ministri i Shoqerise Informatike dhe Administrates.

**Obligimi per integr im**

**Ne ni 19**

(1) Cdo burim i te dhenave eshte i detyruar qe regjistrimin e kryer, ndryshimin ose fshirjen ne bazen e vecante ta integroje ne Regjister ne kohe reale.

(2) Cdo burim i te dhenave eshte i detyruar qe te kryeje ndryshim perkates ne statusin e te dhenave, nese ndryshimi i kryer i te dhenave personale i personit fizik aludon ne nevojen dhe per ndryshimin e te dhenave dhe te njejten ta integroje ne Regjister ne kohe reale.

(3) Menyren dhe procedurat teknike te kryerjes se regjistrimit, ruajtjes dhe fshirjes se te dhenave burimore ne regjistrin i percakton ministri i Shoqerise Informatike dhe Administrates.

**Obligimi per ruaj tje**

**Ne
ni
20**

(1) Organet kompetente dhe subjektet tjera kane per obligim t'i ruajne te dhenat e arkivuara dhe te eksportuara, ne kushte dhe ne procedure te percaktuar me kete ligj, rregullat nga sfera e punes se arkivit dhe rregullat nga sfera e mbrojtjes se te dhenave personale.

(2) Te dhenat e arkivuara para eksportimit te tyre kriptohen ne menyre adekuate ne forme te digjitalizuar ne pajtim me ligjin dhe te njejtat eksportohen nga Regjistri pas skadimit te afatit te percaktuar ligjor per ruajtjen e tyre, me c'rast dorezohen ne Arkivin Shteteror te Republikes se Maqedonise.

**Obligimi per azhurni
m**

**Ne
ni
21**

(1) Cdo burim i te dhenave eshte i detyruar qe t'i azhurnoje setet e te dhenave dhe ndryshimet e statusit te seteve te te dhenave, ne procedure te percaktuar me kete ligj.

(2) Organet kompetente nga paragrafi (1) i ketij neni jane te detyruar qe setet e azhurnuara te te dhenave t'i integrojne ne Regjister.

(3) Kontrolluesi dhe perpunuesi i Regjistrit eshte i detyruar qe permes mjedisit unik te mundesoje integrim te seteve te te dhenave qe kriptohen, ne procedure te percaktuar me kete ligj dhe Ligjin per menaxhim elektronik dhe sherbime elektronike.

**Obligimi per leshim te vertetimit per pranim te kerkeses per regjistrim ose regjistrim te ndryshimit**

**Ne
ni
22**

(1) Ne rastet kur personi fizik inicion procedure per regjistrim te te dhenave burimore ose ndryshim te te dhenave ne Regjister permes shfrytezimit te sherbimit elektronik nga organi kompetent permes Portalit nacional per sherbime elektronike pas gjenerimit te kryer te kerkeses, organi kompetent personit fizik i leshon vertetim per pranim, ne pajtim me Ligjin per menaxhim elektronik dhe sherbime elektronike.

(2) Organi kompetent e leshon vertetimin per pranim nga paragrafi (1) i ketij neni ne forme te porosise se gjeneruar automatike te derguar permes Portalit nacional per sherbime elektronike, ne pajtim me Ligjin per menaxhim elektronik dhe sherbime elektronike.

(3) Permbajtjen dhe menyren e parashtrimit te kerkeses per inicim te procedures per kryerje te regjistrimeve te te dhenave burimore ose ndryshim te te dhenave ne Regjister dhe permbajtjen dhe menyren e leshimit te vertetimit per pranim, i percakton ministri i Shoqerise Informatike dhe Administrates.

**Obligimi per mirembajt
je**

**Ne
ni
23**

(1) Burimet e te dhenave jane te detyruara qe te ndermarrin masa perkatese per mirembajtje te sistemeve ne te cilat perpunohen bazat e vecanta te te dhenave per te cilat jane kompetente ne pajtim me ligjin, t'i vendosin dhe t'i ruajne standardet dhe proceset unike teknologjike per integrim ne Regjister, ne pajtim me ligjin.

(2) Kontrolluesi dhe perpunuesi i Regjistrit eshte i detyruar qe ta mirembaje sistemin e integrimit ne Regjister ne pajtim me ligjin.

(3) Shfrytezuesit e te dhenave nga Regjistri jane te detyruar qe t'i vendosin dhe t'i ruajne standardet dhe proceset unike teknologjike per qasje ne Regjister, ne pajtim me ligjin.

(4) Perpunuesi dhe shfrytezuesi unik i te dhenave nga Regjistri eshte i detyruar qe t'i vendose dhe t'i ruaje standardet dhe proceset unike teknologjike ne Regjister, adekuate me nivelin me te larte te qasjes ne Regjister.

(5) Menyren, procedurat teknike dhe masat per mirembajtje te sistemeve ne te cilat perpunohen bazat e vecanta te te dhenave nga paragrafi (1) i ketij neni, i percakton ministri i Shoqerise Informatike dhe Administrates.

**Obligimi per sigurim te standardeve dhe proceseve unike teknologjike**

**Ne ni 24**

(1) Organet kompetente dhe subjektet tjera jane te detyruara qe t'i ndermarrin masat per sigurim te zbatimit te standardeve dhe proceseve unike teknologjike, para se t'u miratohet qasje ne Regjister, ne pajtim me Ligjin per menaxhim elektronik dhe sherbime elektronike.

(2) Organet kompetente dhe subjektet tjera jane te detyruara qe t'i ruajne standardet dhe proceset unike teknologjike, ne pajtim me Ligjin per menaxhim elektronik dhe sherbime elektronike.

(3) Menyren, procedurat teknike dhe masat te cilat duhet te ndermerren per sigurim te zbatimit te standardeve dhe proceseve unike teknologjike nga paragrafi (1) i ketij neni, i percakton ministri i Shoqerise Informatike dhe Administrates.

**E drejta e qasjes dhe niveli i qasjes**

**Ne ni 25**

(1) Organet kompetente dhe subjektet tjera ne cilesi te shfrytezuesve te te dhenave nga Regjistri kane te drejte te qasjes te te njejtat, nese jane permbushur kushtet e percaktuara me kete ligj dhe me ligjin me te cilin eshte percaktuar kompetenca e tyre, perkatesisht kryerja e veprimtarise.

(2) Qasje te plote ne te dhenat nga Regjistri ka shfrytezuesi dhe perpunuesi unike i te dhenave nga Regjistri, ne pajtim me ligjin.

(3) Qasja ne te dhenat nga Regjistri caktohet ne baze te menyres dhe ne kushte ne te cilat organet kompetente dhe subjektet tjera i sigurojne sherbimet e tyre permes mjedisit unik, ndersa vellimi i shfrytezimit te te dhenave nga Regjistri percaktohet ne baze te regjistrimit ne Katalogun e sherbimeve, ne pajtim me dispozitat e Ligjit per menaxhim elektronik dhe sherbime elektronike.

(4) Me perjashtim te paragrafeve (1), (2) dhe (3) te ketij neni, nese organet kompetente ose subjektet tjera qe kane te drejte te qasjes ne te dhenat nga Regjistri per shkak te ushtrimit t e kompetences se vet ose ushtrimit te veprimtarise per te cilen jane regjistruar, nuk jane regjistruar ne Katalogun e sherbimeve ne pajtim me dispozitat e Ligjit per menaxhim elektronik dhe sherbime elektronike, te njejtat jane te detyruara qe te dorezojne kerkese per percaktimin e qasjes ne te dhena ne Ministrine e Shoqerise Informatike dhe Administrates.

## 2. TE DREJTAT DHE OBLIGIMET E PERSONAVE FIZIKE

### E drejta e keqyrjes

**Ne
ni
26**

(1) Personat fizike kane te drejte te keqyrjes ne te dhenat e tyre personale te perfshira ne Regjister ne forme elektronike, automatikisht ose permes te autorizuarit.

(2) Kontrolluesi dhe perpunuesi i Regjistrit mund t'i leshoje vertetim ne leter personit fizik per te dhenat personale te perfshira ne Regjisten, pas kerkeses se parashtruar paraprake.

(3) Menyren per kryerjen e keqyrjes nga personat fizike ne te dhenat e tyre personale te perfshira ne Regjisten, e percakton ministri i Shoqerise Informatike dhe Administrates, pas mendimit pozitiv paraprak nga organi kompetent per mbrojtjen e te dhenave personale.

### E drejta e notifikimit per shkak te mospajtimit te te dhenave

**Ne
ni
27**

(1) Cdo person fizik te dhenat e te cilit jane perfshire ne Regjister, ne rast te mospajtimit te te dhenave te tij personale, ka te drejte te notifikimit permes Portalit nacional per sherbime elektronike, ne pajtim me dispozitat e Ligjit per menaxhim elektronik dhe sherbime elektronike.

(2) Pas pranimit te notifikimit nga paragrafi (1) i ketij neni, nese te dhenat e evidentuara te cilat ne Regjister jane shenuar si te dhena te sakta, e te njejtat nuk jane te sakta, personi fizik eshte i detyruar qe te kerkoje evidentim te te dhenave te sakta te burimi i te dhenave.

(3) Personi fizik eshte i detyruar qe te kerkoje evidentim te te dhenave te sakta te burimi i te dhenave, me se voni ne afat prej 30 ditesh nga dita e pranimit te notifikimit lidhur me te dhenat nga paragrafi (2) i ketij neni.

(4) Pas evidentimit te realizuar te te dhenave te sakta, personi fizik ka te drejte te notifikimit se eshte kryer regjistrim perkates i ndryshimit te te dhenave personale, permes Portalit nacional per sherbime elektronike, ne pajtim me dispozitat e Ligjit per menaxhim elektronik dhe sherbime elektronike.

(5) Permbajtjen dhe menyren per notifikimin nga paragrafi (1) i ketij neni, i percakton ministri i Shoqerise Informatike dhe Administrates.

## 3. MIRATIMI I INTEGRIMIT NE REGJISTER

**Ne
ni
28**

(1) Organet kompetente dhe subjektet tjera kane te drejte te integrohen dhe t'i shfrytezojne te dhenat nga Regjistri, nese:

- jane te lidhura ne mjedisin unik, perkatesisht ne platforme per interoperabilitet, ne pajtim me Ligjin per menaxhim elektronik dhe sherbime elektronike,

- i kane permbushur ne teresi obligimet qe dalin nga rregullat nga sfera e mbrojtjes se te dhenave personale, ne pajtim me ligjin.

(2) Kushtet nga paragrafi (1) i ketij neni i deshmon organi kompetent ose subjekti gjate parashtrimit te kerkeses per integrim me Regjister ne Ministrine e Shoqerise Informatike dhe Administrates.

(3) Pas kontrollit te kryer per permbushje te kushteve nga paragrafi (1) i ketij neni, Ministria e Shoqerise Informatike dhe Administrates organit kompetent perkatesisht subjektit tjeter i leshon vertetim per integrim ne Regjister, ne pajtim me Ligjin per menaxhim elektronik dhe sherbime elektronike.

### 4. REGJISTRI I ORGANEVE KOMPETENTE DHE SUBJEKTEVE TJERA QE SHFRYTEZOJNE TE DHENA NGA REGJISTRI

**Ne**
**ni**
**29**

(1) Ne Ministrine e Shoqerise Informatike dhe Administrates vendoset dhe mbahet regjister i organeve kompetente dhe subjekteve tjera qe shfrytezojne te dhena nga Regjistri.

(2) Permbajtjen, formen dhe menyren e mbajtjes se regjistrit paragrafi (1) i ketij neni, i percakton ministri i Shoqerise Informatike dhe Administrates.

## IV. MBIKEQYRJA

**Ne**
**ni**
**30**

Mbikeqyrje te zbatimit te ketij ligji kryen Ministria e Shoqerise Informatike dhe A dministrates.

## V. DISPOZITA PER KUNDERVAJTJE

**Ne**
**ni**
**31**

Gjobe ne shume prej 50 deri ne 150 euro ne kundervlere me denare do t'i shqiptohet per kundervajtje personit fizik, nese nuk kerkon evidentim te te dhenes se sakte te burimi i te dhenes ne afat prej 30 ditesh nga dita e zbatimit te notifikimit per mosperputhje te te dhenave, ne pajtim me nenin 27 paragrafi (2) dhe (3) i ketij ligji.

**Ne**
**ni**
**32**

(1) Gjobe ne shume prej 1.500 deri ne 3.000 euro ne kundervlere me denare do t'i shqiptohet per kundervajtje subjektit tjeter nga neni 4 paragrafi (1) pika 7 alinete 2 dhe 3 te ketij ligji, nese:

- i shfrytezojne te dhenat nga Regjistri ne kundershtim me kompetencat e tyre te percaktuara ligjore ose ne kundershtim me veprimtarine per te cilen jane regjistruar (neni 15 paragrafi (1) i ketij ligji),

- nuk kryen regjistrim, regjistrim te ndryshimit, nuk siguron ruajtje ose fshirje te te dhenave burimore, ne pajtim me nenin 18 paragrafi (1) i ketij ligji,

- nuk siguron masa per integrim te sigurt te bazave te vecanta te te dhenave ne Regjister permes mjedisit unik, ne pajtim me nenin 18 paragrafi (2) i ketij ligji,

- nuk siguron masa per ruajtje dhe arkivim te te dhenave, ne pajtim me nenin 20 paragrafi (1) i ketij ligji,

- nuk siguron masa per eksportimin e te dhenave permes kriptimit ne menyre perkatese ne forme te digjitalizuar, ne pajtim me nenin 20 paragrafi (2) i ketij ligji,

- nuk i azhurnon setet e te dhenave, ndryshimet e statusit te seteve te te dhenave, nuk i integron ne Regjister permes mjedisit unik setet e kriptuara te azhurnuara te te dhenave, ne pajtim me nenin 21 te ketij ligji.

- nuk siguron masa perkatese per mirembajtje te sistemeve ne te cilat perpunohen bazat e vecanta te te dhenave per te cilat eshte kompetent ne pajtim me ligjim, nuk i vendos dhe nuk i ruan standardet dhe proceset unike teknologjike per qasje ne Regjister, ne pajtim me nenin 23 paragrafet (1) dhe (3) dhe nenit 24 paragrafi (1) i ketij ligji,

- nuk siguron masa per mirembajtje te standardeve dhe proceseve unike teknologjike, ne pajtim me nenin 24 paragrafi (2) i ketij ligji.

(2) Gjobe ne shume prej 500 deri ne 1500 euro ne kundervlere me denare do t'i shqiptohet per kundervajtje personit udheheqes te organit kompetent ose subjektit tjeter, nese:

- mundeson shfrytezim te te dhenave nga Regjistri ne kundershtim me kompetencat e tyre te percaktuara ligjore ose ne kundershtim me veprimtarine per te cilen jane regjistruar (neni 15 paragrafi (1) i ketij ligji),

- nuk ndermerr masa per ruajtje dhe arkivim te te dhenave, ne pajtim me nenin 20 paragrafi (1) i ketij ligji,

- nuk ndermerr masa per eksportimin e te dhenave permes kriptimit ne menyre perkatese ne forme te digjitalizuar, ne pajtim me nenin 20 paragrafi (2) i ketij ligji,

- nuk merr masa perkatese per mirembajtje te sistemeve ne te cilat perpunohen bazat e vecanta te te dhenave per te cilat eshte kompetent ne pajtim me ligjin, nuk i vendos dhe nuk i ruan standardet dhe proceset unike teknologjike per qasje ne Regjister, ne pajtim me nenin 23 paragrafet (1), (3) dhe (4) dhe nenin 24 paragrafi (1) i ketij ligji,

- nuk merr masa per mirembajtje te sistemit per integrim ne Regjister, ne pajtim me nenin 23 paragrafi (2) i ketij ligji,

- nuk merr masa per mirembajtje te standardeve dhe proceseve unike teknologjike, ne pajtim me nenin 24 paragrafi (2) i ketij ligji.

(3) Gjobe ne shume prej 250 deri ne 750 euro ne kundervlere me denare do t'i shqiptohet per kundervajtje personit udheheqes te organit kompetent ose subjektit tjeter, nese:

- mundeson shfrytezim te te dhenave nga Regjistri ne kundershtim me kompetencat e veta te percaktuara ligjore ose ne kundershtim me veprimtarine per te cilen jane regjistruar (neni 15 paragrafi (2) i ketij ligji),

- nuk kryen integrim te regjistrimit te kryer, ndryshim ose fshirje nga baza e vecante e te dhenave ne Regjister ne kohe reale, ne pajtim me nenin 19 paragrafi (1) i ketij ligji,

- nuk kryen ndryshim perkates ne statusin e te dhenes ose te njejten nuk e integron n e Regjister ne kohe reale, ne pajtim me nenin 19 paragrafi (2) i ketij ligji.

**Neni 33**

Per kundervajtjet e percaktuara me kete ligj, procedure per kundervajtje udheheq dhe sanksion per kundervajtje shqipton gjykata kompetente.

**Ne**
**ni**
**34**

(1) Per kundervajtjet e percaktuara ne nenet 31 dhe 32 te ketij ligji, nepunesi administrativ nga Ministria e Shoqerise Informatike dhe Administrates i autorizuar per kryerje te mbikeqyrjes, eshte i detyruar qe kryeresit te kundervajtjes t'i leshoje urdherpagese per kundervajtje ne pajtim me ligjin.

(2) Nese kryeresi e pranon urdherpagesen per kundervajtje, i njejti duhet ta nenshkruaje. Pranimi i urdherpageses per kundervajtje nga kryeresi i kundervajtjes shenohet ne procesverbal.

(3) Ne procesverbalin nga paragrafi (2) i ketij neni percaktohet menyra ne te cilen do te menjanohen pasojat e demshme nga kundervajtja, si dhe menyra e tejkalimit te pasojave nga kundervajtja e kryer.

(4) Kur si kryeres i kundervajtjes paraqitet personi juridik, procesverbalin dhe urdherpagesen i nenshkruan personi pergjegjes ne personin juridik ose personi i autorizuar nga ai.

(5) Nepunesi administrative nga Ministria e Shoqerise Informatike dhe Administrates per kryerje te mbikeqyrjes, eshte I detyruar qe te mbaje evidence per urdherpagesat e leshuara per kundervajtje dhe per rezultatin nga procedurat e ngritura.

(6) Ne evidencen nga paragrafi (5) i ketij neni mblidhen, perpunohen dhe ruhen te dhenat vijuese: emri dhe mbiemri, perkatesisht emertimi i kryeresit te kundervajtjes, vendbanimi, perkatesisht vendqendrimi, selia, lloji i kundervajtjes, numri i urdherpageses per kundervajtje qe i leshohet edhe rezultati i procedures.

(7) Te dhenat personale nga paragrafi (6) i ketij neni ruhen pese vite nga dita e futjes ne evidence.

(8) Formen dhe permbajtjen e procesverbalit dhe te urdherpageses per kundervajtje, i percakton ministri i Shoqerise Informatike dhe Administrates.

## VI. DISPOZITA KALIMTARE DHE TE FUNDIT

**Ne**
**ni**
**35**

(1) Aktet nenligjore te parapara me kete ligj do te miratohen ne afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes ne fuqi te ketij ligji.

(2) Ministria e Shoqerise Informatike dhe Administrates do te vendose Regjister Qendror te Popullsise, me se voni ne afat prej tre muajsh nga dita hyrjes ne fuqi te ketij ligji.

(3) Marreveshja nga neni 17 paragrafi (2) te ketij ligji do te lidhet me se voni ne afat prej 15 ditesh duke llogaritur nga dita e hyrjes nel fuqi te kletij ligji.

(4) Deri ne diten e pranimit te Republikes se Maqedonise se Veriut ne Bashkimin Evropian, burimet e te dhenave te percaktuara ne nenin 11 paragrafi (1) te ketij ligji, do t'i integrojne te dhenat nga bazat e vecanta te te dhenave ne Regjister, se paku nje here ne cdo 24 ore.

**Ne**
**ni**
**36**

Dispozitat e ketij ligji qe kane te bejne me subjektet tjera nga neni 4 pika 7 e ketij ligji, do te fillojne te zbatohen ne afat prej nje viti nga dita e fillimit te zbatimit te ketij ligji.

**Neni 37**

Ky ligj hyn ne fuqi diten e tete nga dita e botimit ne “Gazeten Zyrtare te Republikes se Maqedonise se Veriut", ndersa do te filloje te zbatohet ne afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes ne fuqi te ketij ligji.